



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 51**

Datë: **24. 09. 2024** ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Procesverbali i mbledhjes së KQZ Nr.50/2024**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të fletëvotimeve
2. Informatë rreth përgatitjeve dhe vizitave për hapjen e kutive postare

#### **3.2.Këshilli për Personel**

1. Shqyrtimi dhe miratimi dhe i rekomandimit për KQZ për listën e kandidatëve potencial për anëtar të Komisionit të Pranimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje të Operacioneve Zgjedhore dhe Koordinimit në Teren.

2. Shqyrtimi dhe caktimi i U.D Drejtorit të SKQZ

**3. Të ndryshme !**

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi**, kryesues i mbledhjes e pasqyroj agjendën, dhe anëtarët e KQZ-së e miratuan agjendën e këtij takimi me vota unanime. Në vazhdim, u shqyrtua procesverbali procesverbali i mbledhjes nr. 50/2024,dhe pastaj u miratua.

**2. Raport i Këshillave të KQZ**

**Këshilli për Operacione Zgjedhore**

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të fletëvotimeve:**

Kjo pikë e rendit të ditës, nuk është shqyrtuar dhe mbetet që të diskutohet edhe njëherë për te, që do të thotë për dizajnin e fletëvotimeve.

**2. Informatë rreth përgatitjeve dhe vizitave për hapjen e kutive postare**

Nga këtu, fillon regjistrimi teknik i mbledhjes: **Arianit Elshani**: ... Rekomandimi është që të jenë dy anëtarë të Sekretariatit, departamenti i shërbimit Votues do ti caktojë dy persona. Nga radhët e KQZ-së, të vendosin vet. E mira është që të kemi një proces, një vizitë që të facilitohet procesi...

**Sami Kurteshi**: Kam disa pyetje. Nuk kam njohuri se çfarë komunikimi ka KQZ me ministrinë e Jashtme. Pse duhet me shkue një delegacion yni në hapje të kutive. Ma mirë është të shkojmë në postë që të shohim si duket kutia psotare, si hapet. E dyta, meqë kutitë sigurohen për një vit, paguhen prej një vit. Me këtë, mbulohe të gjitha...

Ministria është mirë ta sqarojë se, ku Kosova nuk ka përfaqësi diplomatike. Vendet ku nuk kemi përfaqësi, i mbulojnë ambasadat. Për shembull, ambasada në Portugali mund ta mbulojë Spanjën...

Ata, duhet ti sqarojnë! Kjo është punë administrative, dhe ne nuk kemi çka të shkojmë...! Jam kundër të shkojmë se, nuk kemi çka me pa, s'kemi çka me ba, tha ndër të tjera z. Kurteshi.

**Alban Krasniqi**: Nuk është veç ideja me pa, por me i pa edhe kapacitetet që kanë ambasadat, përfaqësitë diplomatike. Kjo madje, ka qenë edhe kërkesë e MPJ-së. Propozimi ka ardh nga ata, por edhe ne e kemi pasur në plan, dhe nuk është veç vizitë por me i pa kushtet, kriteret, kapacitetet...

Unë besoj që është e nevojshme, madje e domosdoshme që të shkohet, sidomos ata që janë nga shërbimi votues, dhe nuk jemi për të bërë presion por të dakordohemi dhe mendoj që kjo nuk është veq vizitë por është punë jona. Për herë të parë po e organizojmë këtë proces jashtë vendit, dhe janë disa çështje që duhet ti kemi parasysh, t'i përgatisim procedurat, komunikimin etj. Është e domosdoshme të shkojmë...

**Sami Hamiti**: Konsideroj që duhet të shkohet gjithsesi. Nuk është vetëm çështje e fahut postal, çështje teknike, por janë edhe çështjet e infrastrukturës, procedurat, organizimi, formatet teknike...Dhe KQZ duhet me shkue, nuk diskutohet kjo punë...! KQZ, duhet me ditë si trajtohen, si menaxhohen...

**Alban Krasniqi**: Më së miri, si këshill me marrëdhënie me jashtë apo në parim, ta aprovojmë këtu...

**Kreshnik Radoniqi**: Të diskutohet edhe njëherë në këshill, të jepen edhe propozimet, e mandej ne vendosim...

### **3. Këshilli për Personel**

Shqyrtimi dhe miratimi dhe i rekomandimit për KQZ për listën e kandidatëve potencial për anëtar të Komisionit të Pranimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje të Operacioneve Zgjedhore dhe Koordinimit në Teren:

**Kreshnik Radoniqi**: E kemi një ftesë, nga 3-5 dhjetorë 2024, por kanë kërkuar herët konfirmimin. E kemi ftesën unë dhe Kreshnik spahiu. Nëse ka interesim dikush, mund të shkoj në vendin tim...

Si ishte, një ftesë mbi zgjedhjet... Ky takim mbahet në Tiranë. Mirë, marrin pjesë Albani dhe Kreshniku...

Me tetë vota për, miratohet.

Shqyrtimi dhe miratimi i listës së anëtarëve të komisionit të pranimit për pozitën e udhëheqësit të Divizionit për Mbështetje të Operacioneve Zgjedhore dhe Koordinimit në Teren

**Alban Krasniqi**: Lidhur me panelin e përzgjedhjes së atyre që kanë konkurruar. Përbërja e panelit, duhet të jetë e përbërë me anëtarë nga brenda, dhe jashtë institucionit. Është fjala e shqyrtimit të listës së kandidatëve potencial për anëtarë të komisionit të pranimit për pozitën e udhëheqësit të Divizionit për Mbështetje të Operacioneve Zgjedhore dhe Koordinimit në Teren. Në bazë të raportit që kemi, përbërja

është prej 5 anëtarëve. Kryesues është Haki Krasniqi, Kreshnik Spanihu, Albion Rexhepi (jashtë institucionit) nga Autoriteti i Konkurrencës, Erblin Etemi, MAPL dhe Vahide Behrami.

Ky panel, rekomandojmë të pranohet.

Me 10 vota për, rekomandimi u miratua nga anëtarët e KQZ.

#### **4. Shqyrtimi dhe caktimi i U.D Drejtorit të SKQZ:**

**Kreshnik Radoniqi:** Drejtorit të SKQZ-së, sot i kalon mandati. Pozitën e tij, nuk mund ta lëmë vakant dhe ne, duhet ta caktojmë një ushtrues detyre. Unë kisha për propozim Besnik Buzhalën dhe Kreshnik Spahiun. Kreshniku, nuk ka pranuar kështu që, na mbetet z. Buzhala.

**Fazli Stollaj:** Deri ku ka mbërri faza e konkursit...?

**Alban Krasniqi:** Procesi është në fazën e verifikimit të dosjeve të kandidatëve.

**Sami Hamiti:** E kemi diskutue, dhe në këtë rast, Kreshniku është tërhequr...! Por, rastin e ish kryeshefit duhet me e shqyrtua. Duhet ta sistemojmë...

**Alban Krasniqi:** Kemi kërkue që ish kryeshefi, të informohet me të gjitha të drejtat që i takojnë. Për tre muaj, ai e merr pagën e plotë. Mund të ketë ndonjë pozitë profesionale, por të shohim si na shkojmë konkurset... Për pozitën profesionale, direkt transferohet...

**Arianit Elshani:** Jemi në proces, dhe ai është i profesionalizuar. Dhe, duhet të diskutojmë, ta shohim nëse edhe ai ka interesim...

**Kreshnik Radoniqi:** Nëse nuk ka tjetër propozim, kush është që z. Besnik Buzhala të zgjidhet ushtrues i detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së ?

**Alban Krasniqi:** vetëm ta kujtojmë se, i njëjti nuk mund të zgjedhjet më shumë se gjashtë plus gjashtë muaj.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, diskutuan lidhur me vizitat jashtë vendit që lidhen me procesin e votimit për zgjedhjet Parlamentare të 9 shkurtit, 2024.

Lidhur me vizitat jashtë vendit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës që lidhen me votim jashtë vendit, u vendos: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Lirik Krasniqi dhe Premtim Rrustemi.

Me 10 vota për, u miratuan këto propozime.

## **5. Të ndryshme !**

---

**Post scriptum:** *Ka qenë e pamundur të shtjellohet më shumë material nga mbledhja për shkak të problemeve teknike në incizim...*